

PAULO COELHO  
**VERONIKA VENDOS TË VDESE**  
ROMAN

---

BOTIMET TOENA



PAULO COELHO

VERONIKA VENDOS  
TË VDESE

*roman*

Përktheu  
Nonda Varfi

BOTIMET TOENA  
Tiranë, 2022

Titulli në origjinal: *Veronika decide morrer*  
Titulli në frëngjisht: *Veronika décide de mourir*

*Ky libër u botua sipas marrëveshjes me  
Sant Jordi Asociados Agencia Literaria S.L.U., Barcelona, Spain.  
www.santjordi-asociados.com  
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.*

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo  
Korrektore letrare: Edona Marku  
Përkujdesja grafike: Edona Marku  
© e kopertinës: Jim Tierney, në bashkëpunim me HarperCollins,  
me bazë në Nju-Jork, SHBA.

ISBN 978-9928-348-79-1

© Paulo Coelho, 1998  
<http://paulocoelhoblog.com>  
© *në shqip* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi  
me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me  
shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

[www.toena.al](http://www.toena.al)

Oh, Marie e ngjizur pa mëkatuar,  
lutu për ne që përgjërohemi për Ty!  
Amen.

Për S. T. de L., që nisi të më ndihmojë ndërkohë që nuk e dija.

## Vlerësime për romanin “Veronika vendos të vdesë”

“*Veronika vendos të vdesë*’ është vepra më artistike e Coelho-s deri tani... Personazhe të ndryshme debatojnë në lidhje me mendjen e shëndoshë dhe jetën, nga këndvështrime të ndryshme, duke e tërhequr lexuesin në diskutim.”

~ **Denver Post**

“*Një tregim i rrëfyer me sinqeritet... një roman i dobishëm.*”

~ **Boston Globe**

“*Një fabul prekëse mbi të mësuarit se si të zgjedhësh jetën përkundrejt vdekjes.*”

~ **Kirkus Reviews**

“*Coelho nuk u drejtohet aq shumë lexuesve të tij ndërsa u rrëfëhet. Stili i tij është një lloj zbulimi, plot me pëshpërime lirike dhe rrëfime të lëna mënjanë.*”

~ **The Sunday Express** (Londër).

“*Libri më i shitur i globit ‘Alkimisti’ krijoi reputacionin e Coelho-s dhe ‘Veronika vendos të vdesë’ e riafirmoi atë.*”

~ **Time Out**

“*Me ‘Veronika vendos të vdesë’ legjenda e Coelho-s vazhdon të rritet.*”

~ **La Prensa** (Argjentinë).

Pra, ju kam dhënë pushtetin që të shtypni me këmbë gjarpërinjtë (...)  
dhe mos u druani nga asgjë.

Luka, 10,19





Më 11 nëntor 1997, Veronika mendoj se kishte ardhur më në fund çasti të vriste veten. Pastroi me kujdes dhomën që kishte marrë me qira në një kuvend murgeshash, mbylli ngrohjen, lau dhëmbët dhe u shtri.

Mori mbi komodinë katër kuti me qetësues. Në vend që t'i shtypte dhe t'i treste në ujë, pëlqeu t'i kapërdinte një nga një, sepse nga qëllimi te akti ka një hendek të madh, ndërkohë që ajo dëshironte të ishte e lirë për t'u penduar në gjysmë të rrugës. Megjithatë, mbas çdo qetësuesi që kapërdinte, ndihej më tepër e bindur. Pas pesë minutash, kutitë ishin zbrazur.

Meqenëse nuk e dinte saktësisht se kur do të humbiste ndjenjat, kishte lënë mbi shtrat numrin e fundit të revistës *Homme*, që sapo kishte mbërritur në bibliotekën ku punonte. Edhe pse nuk kishte ndonjë interes të veçantë për informatikën, duke shfletuar atë revistë, kishte hasur një shkrim në lidhje me një lojë elektronike (një CD-Rom, siç thuhet) të shpikur nga Paulo Coelho. Ajo kishte patur rastin ta takonte shkrimtarin brazilian gjatë një konference në sallonet e hotel *Grand Union*. Kishin shkëmbyer

disa fjalë dhe, më në fund, ishte ftuar në darkën që jepte botuesi. Por atje, kishte shumë të ftuar dhe ajo nuk kishte mundur të çonte gjer në fund asnjë bisedë me të.

Megjithatë, fakti që njohu atë autor e nxiti të mendonte se bënte pjesë në të njejtën botë me të dhe se leximi i një reportazhi kushtuar punës së tij mund ta ndihmonte për të kaluar kohën. Kështu, ndërkohë që priste vdekjen, Veronika nisi të lexonte një shkrim për informatikën, gjë që nuk i interesonte fare. Dhe pikërisht kështu ishte sjellë gjatë gjithë jetës, duke kërkuar gjithnjë rrugën e thjeshtë, ose duke u kënaqur me ç't'i gjendej pranë - si kjo revistë, bie fjala.

Megjithatë, për çudinë e saj të madhe, rreshti i parë i tekstit e nxorri nga plogështia e natyrshme (qetësuesit nuk ishin tretur ende në stomak, por Veronika ishte e tërhequr nga natyra). Për herë të parë në jetë, një thënie që ishte shumë në modë mes miqve, iu duk me vend: «Asgjë në këtë botë nuk ndodh rastësisht.»

Përse hasi ato fjalë, pikërisht në çastin kur kishte vendosur të vdiste? Cili ishte kumti i fshehtë që fshihnin, nëse ka vërtet kumte të fshehta në mos po rastësira?

Poshtë një ilustrimi të lojës elektronike, gazetari e niste shkrimin me një pyetje: «Ku ndodhet Sllovenia?»

«Askush nuk e di ku ndodhet Sllovenia, mendoj Veronika. Askush.»

Megjithatë, Sllovenia egzistonte mirë e bukur, ndodhej aty, në atë dhomë, përjashta, te malet që e rrethonin dhe te sheshi që kishte pëpara syve: Sllovenia ishte vendi i saj.

Veronika e la mënjanë revistën. Nuk i mbetej veçse të pezmatohet me botën që mohonte ekzistencën e sllovenëve. Për nderin e kombit nuk shqetësohej. Ishte çasti për t'u ndier krenare me veten, sepse, më në fund, kishte marrë guximin të largohej nga kjo jetë. Çfarë lumturie! Dhe ajo e kryente atë akt ashtu siç e kishte ëndërruar gjithë kohën: me qetësues, çka nuk lë gjurmë.

Veronika ishte vënë në kërkim të qetësuesve që prej gjashtë muajsh. Me mendimin se nuk do të arrinte kurrë t'i gjente, kishte menduar një çast të priste damarët. E dinte se dhoma do të mbushej me gjak, se do të mbillte trazim e shqetësim te murgeshat, por vetvrasja kërkon që të mendosh së pari për veten, pastaj për të tjerët. Ajo do të bënte çmos që vdekja të mos shkaktonte shumë trazira; megjithatë, nëse nuk kishte tjetër mundësi përveç prerjes së damarëve, aq më keq. Sa për murgeshat, ato duhet të nxitonin ta harronin historinë dhe të pastronin dhomën, nga frika se mos nuk e jepnin dot më me qira. Mandej, edhe në fund të shek XX, njerëzit besonin ende te fantazmat.

Sigurisht, Veronika mund të hidhej edhe nga maja e ndonjë ndërtese të lartë e të rrallë, të Lubljanës, por një vendim i këtillë a nuk do t'u shkaktonte dhimbje më të madhe prindërve? Përveç tronditjes, kur të merrnin lajmin për vdekjen e vajzës, atyre do t'u duhej të identifikonin edhe kufomën: jo, kjo zgjidhje ishte më e keqe se zbraza e gjakut, sepse do të linte gjurmë të pashlyeshme të dy njerëzit që i donin të mirën.

«Më në fund, do të mësohen me vdekjen e vajzës. Por, të harrosh një kafkë të çarë, nuk është e lehtë.»

Të vrisje veten me armë zjarri, të hidheshe nga një ndërtesë, të vareshe, asnjëra nga këto nuk i shkonte për shtat natyrës së saj femërore. Gratë, kur vrasin veten, zgjedhin mënyra më romantike - presin venat ose gëlltisnin ndonjë dozë të madhe qetësuesish. Princeshat e braktisura dhe aktoret e Hollivudit kanë dhënë shembuj të ndryshëm.

Veronika e dinte se gjithnjë duhej pritur çasti i duhur për të vepruar. Dhe atë kishte bërë. Duke e dëgjuar shpesh të ankohej për pagjumësi, dy nga miqtë e saj, të ndjeshëm ndaj ankesave, kishin gjetur secili dy kuti me një drogë të fuqishme që përdornin muzikantët e një kabareje të qytetit. Veronika i kishte lënë të katër kutitë mbi komodinë për një javë, duke pritur afrimin e vdekjes dhe duke lënë shëndetet, pa më të voglin sentimentalizëm për atë që quhet Jetë.

Tani, ishte e lumtur që përmbushte vendimin, por mërzhitej ngaqë nuk dinte si ta shtynte atë pak kohë që i mbetej.

Mendja i vaji sërish tek absurditeti që sapo kishte lexuar. Si ka mundësi që një shkrim për informatikën të nisë me këtë fjali të çuditshme: «Ku ndodhet Sllovenia?»

Duke mos patur gjë tjetër më tërheqëse për të bërë, vendosi të lexojë reportazhin deri në fund dhe zbuloi se loja kishte qenë prodhuar në Slloveni - në atë vend të çuditshëm që - përveç banorëve të saj - me sa dukej nuk e dinte kush se ku ndodhej - sepse atje krahu i punës ishte tepër i lirë. Disa muaj më parë, për hedhjen në qarkullim të lojës, prodhuesja franceze kishte ftuar gazetarë nga e gjithë bota dhe kishte dhënë një pritje në një kështjellë, në Bled.

Veronika u kujtua se kishte dëgjuar të flitej për atë festë si ngjarje në qytet, jo vetëm sepse, me atë rast, kështjellën e kishin zbukuruar sërish për të krijuar sa më shumë që të qe e mundur atmosferën mesjetare të CD-Rom-it, por edhe për shkak të polemikës që kjo gjë kishte shkaktuar në shtypin lokal: ishin ftuar gazetarë gjermanë, francezë, anglezë, italianë, spanjollë, por asnjë bolivian. Autori i shkrimit - i cili vinte në Slloveni për herë të parë, me të gjitha harxhet e hequra dhe tepër i vendosur për të lajkatur gazetarët e tjerë, për të këmbyer biseda gjasme tërheqëse, për të ngrënë e pirë në kështjellë pa e

zgjdhur qesen - e kishte nisur, kështu, shkrimin me një shaka që synonte të guduliste intelektualët më të shquar të vendit. Atij iu desh, gjithashtu, t'u rrëfente miqve të redaksisë disa historira të shpikura rreth zakoneve të vendit, ose për mënyrat e prapambetura të veshjes së grave sllovene.

Punë për të. Veronika, duke vdekur, kishte halle të tjera, për shembull të dinte në ekzistonte jetë tjetër përtej vdekjes ose në ç'orë do t'ia gjenin kufomën. Megjithatë - ose ndoshta pikërisht për shkak të vendimit të rëndësishëm që kishte marrë -, ky shkrim e shqetësonte.

Hodhi vështrimin nga dritarja e kuvendit që binte nga ana e sheshit të Sllovenisë. «Nëse nuk e dinë ku ndodhet Sllovenia, mendoj, do të thotë se Ljubljana është mit.» Si Atlantida a Lemuria, ose kontinentet e zhdukura që s'i ndahen një çap imagjinatës së njerëzve. Askush në botë nuk do ta niste shkrimin me pyetjen se ku gjendet mali Everest, edhe pse nuk ka qenë kurrë atje. Megjithatë, në mes të Europës, një gazetari të një reviste të dëgjuar nuk i vinte turp të bënte një pyetje të tillë, sepse e dinte se shumica e lexuesve nuk e dinë ku gjendej Sllovenia. Aq më tepër, kryeqyteti, Ljubljana.

Atëhere, Veronika zbuloi mënyrën për të kaluar kohën. Dhjetë minuta rodhën dhe nuk kishte vërejtur ende asnjë ndryshim në organizëm. Akti i fundit i

jetës do të qe shkrimi i një letre për atë revistë, duke i shpjeguar se Sllovenia ishte një nga pesë republikat që kishin dalë nga shpërbërja e Jugosllavisë së dikurshme. Ajo letër do të ishte pusulla e lamtumirës. Madje, nuk do të jepte asnjë sqarim mbi arsytet e vërteta të vdekjes.

Kur të zbulonin trupin, do të arrinin në përfundim se kishte vrarë veten ngaqë një revistë nuk dinte se ku ndodhej vendi i saj. Qeshi duke sjellë ndër mend polemikën në gazeta. Disa do ta mbronin, të tjerët do ta kritikonin vetvrasjen e bërë për hir të çështjes kombëtare. Dhe u çudit nga shpejtësia, me të cilën kishte ndërruar mendim, sepse, përkundrazi, disa çaste më parë, mendonte se bota dhe çështjet gjeografike nuk i hynin më në punë.

Ajo hartoi letrën. Ky çast i një humori të mirë pothuajse desh vuri në pikëpyetje nevojën për të vdekur, por, ndërkohë, i kishte gëlltitur qetësuesit, ishte tepër vonë për t'u kthyer mbrapsht.

Gjithsesi, kishte jetuar tashmë çaste të tilla dhe nuk e vriste veten sepse ishte e trishtuar, e hidhëruar, ose vazhdimisht e rëgjuar shpirtërisht. Shpesh, mbas dite, kishte ecur e lumtur në rrugët e Ljubljanes, ose kishte parë, nga dritarja e dhomës, borën që binte mbi sheshin e vogël ku ngrihej statuja e poetit. Një herë, ishte bërë me flatra për afro një muaj sepse një i panjohur, në qendër të po atij sheshi, i kishte dhuruar një lule.

Ajo ishte e bindur se qe plotësisht normale. Vendimi për të vrarë veten mbështetej në dy arsye shumë të thjeshta dhe ishte e sigurt se po të linte një pusullë për të shpjeguar veprimin, shumë njerëz do ta miratonin.

Arsyeja e parë: gjithçka në jetë ishte e ngjashme dhe, sapo të kalonte moshën e rinisë, do të vinte rënia, pleqëria që lë gjurmë të pakthyeshme, sëmundje, miq që zhduken. Nuk do të fitonte asgjë po të vazhdonte të jetonte; përkundrazi, rreziqet e vuajtjes veç do të shtoheshin.

Arsyeja e dytë kishte natyrë filozofike: Veronika lexonte gazetën, shikonte televizorin dhe ishte në dijeni të çka ndodhte në botë. Punët shkonin keq dhe ajo nuk kishte asnjë mundësi për ta rregulluar gjendjen, çka i shkaktonte një ndjenjë kotësie të plotë.

Por, pas pak kohe, do të provonte një përvojë të fundme - vdekjen -, një përvojë që kishte gjasa të ishte shumë e ndryshme. Me të përfunduar letrën, u përqendrua në çështjet më të rëndësishme dhe më të qënësishme në çastin që po jetonte - ose më mirë po vdiste.

U përpoq të merrte me mend vdekjen, por më kot. Gjithsesi, nuk kishte pse të shqetësohej, sepse pas disa çastesh do ta merrte vesh.

Sa minuta? Nuk kishte as më të voglën ide. Por gëzonte, ngaqë do ta merrte së shpejti përgjigjen e pyetjes që shtronte gjithë bota: A ka Zot?



Në kundërshtim me shumë të tjerë, këtë çështje nuk e kishte kthyer në debat të madh të brendshëm të qenies së saj. Në rregjimin e vjetër komunist, edukimi zyrtar i kishte mësuar se jeta mbaron me vdekjen dhe ajo ishte mësuar me këtë ide. Nga ana e tyre, brezat e prindërve dhe të gjyshërve të saj shkonin ende në kishë, thoshin lutje, bënin shtegtime dhe e kishin mendjen top se Zoti ua vinte veshin fjalëve të tyre.

Në moshën njëzet e katër vjeç, pasi kishte jetuar gjithçka që kishte mundur - dhe, mos harroni se nuk ishte pak! - Veronika ishte pothuajse e sigurt se të tëra merrnin fund me vdekjen. Për këtë arsye, kishte zgjedhur vetvrasjen: më në fund, do të vinte liria, harresa e përrjetshme.

Por, thellë në shpirt, dyshimi egzistonte. Po sikur të ketë Zot? Mijëvjeçarët e njerëzimit e kishin kthyer vetvrasjen në tabu, në fyerje të madhe për kodet fetare: njeriu lufton për të mbijetuar, jo për t'u dorëzuar. Raca njerëzore duhet të shtohet. Burri dhe gruaja kanë nevojë për një shkas që të rrinë së bashku edhe kur dashuria ka marrë fund, dhe çdo vend ka nevojë për ushtarë, politikanë, artistë.

«Nëse ka Zot, gjë të cilën sinqerisht nuk e besoj, Ai duhet të kuptojë se ka një cak në mirëkuptimin njerëzor. Vetë e ka krijuar këtë rrëmujë, ku gjithçka është vetëm skamje, padrejtësi, lakmi, vetmi. Qëllimi ishte pa dyshim i mrekullueshëm, por rezultatat janë një hiç; në ka Zot, Ai duhet të tregohet i butë

me krijesat që kanë dëshirë të largohen më shpejt. Ai mund të na kërkojë të falur që na ka detyruar të kalojmë nga kjo Botë.»

Në djall vafshin tabutë dhe supersticionet! Nëna ishte shumë besimtare, i tregonte se Zoti e njihte të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen. Në këtë rast, Ai e kishte sjellë në jetë me ndërgjegje të plotë se ajo do të vriste veten një ditë dhe Ai nuk do të tronditej nga ky veprim.

Ndërkaq Veronikës i erdhi për të vjellë, ndjenjë që u shtua me shpejtësi.

Disa çaste më pas, nuk mund të përqendrohej te pamja para dritares. Ishte dimër. Ora duhej të ishte rreth katër mbasdite dhe ndërkohë dielli po perëndonte. Ajo e dinte se jeta e njerëzve do të vazhdonte. Në atë çast, një djalë që po kalonte pranë saj e vuri re, pa dyshuar aspak se ajo ishte duke dhënë shpirt. Një grup muzikantësh bolivianë (Ku ndodhet Bolivia? Përse shkrimet e gazetave nuk e bëjnë këtë pyetje?) luanin para statujës së Frenc Presherenit, poetit të madh slloven që ka lënë gjurmë të thella në shpirtin e popullit të tij.

A do të arrinte ta dëgjonte deri në fund muzikën? Do të ishte një kujtim i bukur i kësaj jete: perëndimi, melodia që ndillte ëndrrat e skajit tjetër të botës, dhoma e ngrohtë dhe e rehatshme, kalimtari i bukur plot jetë që kishte vendosur të qëndronte dhe që tani i kishte ngulur sytë.

Ndërkohë që ndjente efektin e ilaçeve, e dinte se ai ishte njeriu i fundit që do të shikonte. Ai ia bëri me shenjë. Me sa duket, dëshironte të shkonte tepër larg. Ajo vendosi të shtirej sikur vështronte gjetiu. I turbulluar, ai vazhdoi rrugën, duke e harruar përgjithmonë fytyrën në dritare.

Por Veronika ishte e lumtur që kishte qenë dhe një herë joshëse. Ajo nuk e vriste veten për mungesë dashurie. Nuk e bënte për mungesë dhembshurie familjare, as për shkak të problemeve financiare apo të ndonjë sëmundjeje të pashërueshme.

Veronika kishte vendosur të vdiste atë pasdite të bukur, ndërkohë që bolivianët luanin në sheshin Ljubljana dhe një djalosh kalonte përpara dritare të saj. Ishte e lumtur me çka i shikonin sytë dhe i dëgjonin veshët. Ishte edhe më e lumtur, ngaqë nuk do të merrte pjesë në të njëjtën shfaqje për tridhjetë, dyzetë a pesëdhjetë vjet - sepse kjo do ta humbiste tërë origjinalitetin dhe do të kthehej në tragjedi e një jete, ku gjithçka përsëritet dhe ku e nesërmja është gjithnjë e ngjashme me të djeshmen.

Tani po i vinte të përzier dhe ndjehej keq. «Eshtë e çuditshme. Mendoja se një dozë e madhe qetësuesish do të më vinte në gjumë menjëherë.» Por ndjente një gumëzhimë të çuditshme në veshë dhe i vinte për të vjellë.

«Po volla, nuk do të vdes.»

Vendosi ta harrojë pështjellimin. U përpoq të përqendrohej te nata që po binte me nxitim, te bolivianët, te shitësit që mbyllnin dyqanet për t'u kthyer në shtëpi. Zhurma në veshë po bëhej më e mprehtë dhe, për herë të parë, që nga çasti që kishte kapërdirë qetësuesit, Veronika ndjeu frikë, një frikë të tmerrshme nga e panjohura.

Por, kjo ndjesi zgjati pak. Në çast ra në kllapi.